

Fjala e kryetarit të Akademisë, me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes së bashkëpunimit midis Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Mbishkrimeve dhe të Letërsisë (Académie des Inscriptions et Belles-Lettres) dhe mbajtjes së ligjëratës së Sekretarit Permanent, akademik prof. dr. Michel Zink,

Të nderuar kolegë dhe miq,

Pas ceremonisë së nënshkrimit të Marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy akademive, përfaqësuesi i Akademisë së Mbishkrimeve dhe të Letërsisë (Académie des Inscriptions et Belles-Lettres), Sekretari permanent, prof. Michel Zink, do të mbajë një ligjëratë. Para ligjëratës, më lejoni që ta paraqes një tablo të shkurtër të biografisë dhe të punës së tij akademike, shkencore-hulumtuese dhe krijuese.

Prof. Zink, filolog dhe medievist, lindi në vitin 1945 në Issy-les-Moulineaux, afër Parisit. Është specialist i filologjisë dhe letërsisë mesjetare të Francës, të shekujve XII-XV, i filologjisë dhe i letërsisë religjioze, i historiografisë dhe historisë së përgjithshme të letërsisë frënge të Mesjetës.

Pasi i kreu studimet në *École Normale supérieure* më 1968, në vitet 1976-1987 ishte profesor në Universitetin e *Toulouse-it II-Le Mirail*, pastaj në vitet 1987-1994 në *Universitetin e Sorbonës IV*. Nga viti 1995 ligjëron në *Collège de France* letërsinë mesjetare franceze. Prof. Zink gjithashtu ka ligjëruar në disa universitete prestigjioze jashtë Francës, si në Yale, Berkley të Kalifornisë, në Arizona, Pensilvania, Çikago, në Sapienca të Romës, në Stanford Univesity, në Universitetin e Cyrihut etj.

Në edicionin *Livres de poche* (Librat e xhepit) drejton koleksionin *Letërsia gotike*, si dhe drejton revistën *Romania* që merret me gjuhët dhe letërsinë romane.

Në vitin 2000 u zgjodh anëtar i Akademisë Frënge të Mbishkrimeve dhe të Letërsisë (Académie des Inscriptions et Belles-Lettres), e themeluar në vitin 1663 nga Luigji XIV. Në vitin 2011 ishte kryetar i kësaj Akademie, ndërsa sot është sekretar permanent i saj. Nga viti 1996 është dhe anëtar i Akademisë Amerikane të Arteve dhe të Shkencave.

Bibliografia e tij është shumë e gjerë. Janë dhjetra e dhjetra botime nga fushat e interesimit të tij shkencor e letrar, filologjia, letërsia mesjetare frënge, studime, interpretime, komente, analiza, çka e bën atë njërin nga ekspertët më të shquar frëngë në këto fusha.

Për rezultatet në punën e tij mori disa shpërblime e dekorata, sikurse “Komandor i Urdhrit të Palmave Akademike” (“Commandeur dans l’Ordre de Palmes Académiques”), “Kalorës i Legjionit të Nderit” (“Chevalier de la Legion d’Honneur”), çmimin e “Asociacionit të Studimeve Franceze” (“Association des Études Françaises”) etj.

Në Prishtinë

14 nëntor 2016